



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 26.2.2025

Nr: 206

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE PARTIA “DJATHTAS 1912”,
ME ORGAN DREJTUES “KOLEGJI POLITIK”, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT
ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025**

Sot më datë 26.2.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1235, Prot., datë 24.02.2025, me:

Kërkues: Partia politike Partia “Djathtas 1912”, me organ drejtues Kolegji Politik i përbërë nga Z. Arbi Agalliu, Z. Enkelejd Alibeaj, Zj. Ersilda Çelaj, Z. Agron Kapllanaj, Zj. Edlira Devolli, Z. Edvin Kulluri dhe Zj. Eva Vako

Objekti: Shqyrtimin e kërkesës së partisë politike Partia “Djathtas 1912” për regjistrim si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025

Baza ligjore: Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvend.

Partia “Djathtas 1912”, nëpërmjet organit drejtues Kolegji Politik i përbërë nga Z. Arbi Agalliu, Z. Enkelejd Alibeaj, Zj. Ersilda Çelaj, Z. Agron Kapllanaj, Zj. Edlira Devolli, Z. Edvin Kulluri dhe Zj. Eva Vako, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

Data: 26.2.2025 Nr: 206
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike Partia “Djathtas 1912” me organ drejtues “Kolegji Politik”, për regjistrim si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025”.

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 19.02.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia “Djathtas 1912”, me organ drejtues Kolegji Politik i përbërë nga Z. Arbi Agalliu, Z. Enkelejd Alibeaj, Zj. Ersilda Çelaj, Z. Agron Kapllanaj, Zj. Edlira Devolli, Z. Edvin Kulluri dhe Zj. Eva Vako, rezultojnë të regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02).
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër dhe nga përmbajtja e kërkesës rezultojnë se:

- a) Emri zyrtar i partisë është Partia “Djathtas 1912”, me adresë: Rruga e Kavajës, "Square 21", Shk. 4, Tiranë;
- b) Me organ drejtues Kolegji Politik i përbërë nga Z. Arbi Agalliu, Z. Enkelejd Alibeaj, Zj. Ersilda Çelaj, Z. Agron Kapllanaj, Zj. Edlira Devolli, Z. Edvin Kulluri dhe Zj. Eva Vako, me adresë: Rruga e Kavajës, "Square 21", Shk. 4, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Zj. Eriselda Çelaj, me adresë: Rruga e Kavajës, "Square 21", Shk. 4, Tiranë;
- d) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është Z. Trimir Marku, me adresë: Rruga e Kavajës, "Square 21", Shk. 4, Tiranë;
- e) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga Partia “Djathtas 1912”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga Partia “Djathtas 1912” është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.01.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 Maj 2025.

V E N D O S :

1. Regjistrimin e partisë politike Partia “Djathtas 1912”, me organ drejtues Kolegji Politik i përbërë nga Z. Arbi Agalliu, Z. Enkelejd Alibeaj, Zj. Ersilda Çelaj, Z. Agron Kapllanaj, Zj. Edlira Devolli, Z. Edvin Kulluri dhe Zj. Eva Vako, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI